5875
11.07.2025

Miratohet

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LUSHNJE

NJOFTIM PUBLIK

Për shtyerjen e afatit për aplikimet e programit social te strehimit Subvencionit të Interesave të Kredisë për vitin 2025.

Ministria e Ekonomisë Kulturës dhe Inovacionit, Drejtoria e Strehimit ka bërë thirrje për aplikimin e programit "Subvecionimin e interesave të kredisë". Për Bashkinë Lushnje janë në dispozicion ende kuota për familjet e pastreha të interesuara për këtë program.

Këto familje përfitojnë kredi me interes 3% në vitë.

Programi i subvencionimit të interesave të kredisë do të vazhdojë të zbatohet nga tre banka të nivelit të dytë me të cilat MEKI ka marrëveshje qe nga viti 2019(Intesa SanPaolo Bank, Raiffeisen Bank, Banka Kombëtare Tregtare), do të targetojë familjet/individë që nuk disponojnë banesë në pronësi.

Përparësi në përzgjedhje do të kenë:
1.Familje të reja dhe të rinj me moshë jo më të madhe se 40 vjec.
2. Gra kryefamiljare/ gra të dhunuara
3. Familjet njëprindërore që kanë në ngarkim fëmijë
4.Familjet me më shumë se 4 fëmijë
Përparësitë e përcaktuara më sipër nuk përjashtojnë individë a familje që nuk bëjnë pjesë në këto grupe.
Thirrja do të vazhdojë të jetë e hapur nga data **11.07.2025** deri në datën **18.07.2025** për te interesuarit e ketij programi, të cilët duhet te aplikojnë në sistemin online **e-albania**.

Gjithashtu për cdo paqartësi të paraqiten pranë Drejtorisë së Shërbimit Social.

Përgjegjës i komanduar i Shërbimit Social

Renard Korreshi

Adresa:Lagjia "Kongresi i Lushnjes" Tel:+355 35 222139 E-mail:bashkia_lushnje@yahoo.com